

24.12.2015

F. 13



24.12.2015

C.nr.192/15

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**, departamenti I eprgjithshem-divizioni civil, gjyqtari Enes Mehmeti dhe procesmbajtesja minire Krasniqi, ne ceshtjen juridiko-kontestimore te inicuar me padine e paditases [redacted] dega ne [redacted] rr" [redacted] [redacted], kunder te paditurve [redacted] dhe [redacted] nga [redacted] rr" [redacted] [redacted], per pgesen e borxhit, jashte séance me date 03.11.2015, merr ketë:

### AKTGJYKIM

#### -PER SHKAK TE PADEGJUESHMERISE/MOSBINDJES-

**APROVOHET** kërkesëpadija e paditëses Banka ekonomike SHA, me seli ne Prishtine, si e bazuar.

**DETYROHET** te paditurit [redacted] dhe [redacted] nga [redacted] rr" [redacted] [redacted], që paditëses t'ia paguan shumën prej 1360.00€ (njemijetreqindegjashtedhjeteuro), në emër të te pagesën së borxhit te mbetur nga mospermbushja e marreveshjes se kredise, së bashku me kumatën e cila do të llogaritet sipas lartesisë qe aplikojne bankat per deponimet e rendomta te qytetareve per periudhe njevjecare, pa destinim te caktuar, nga dita e ushtrimit te padise, date 31.03.2015 e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedures në shumë prej 40.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.


**OBLIGOHET** paditësja që të paguan taksën gjyqësore për aktgjykim, në shumë prej 20.00€, mënjherë pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimi e përmbarimit me forcë.

### Arsyetimi

Paditësja, në ketë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurit, për shkak se I apdituri nuk ka permbushur detyrimet e tij kontraktuese sipas marreveshjes per kredine nr. Nr.KOFE-007084-002 dates 28.10.2013.

Gjykatës i kanë bashkangjitur provat dhe dëshmitë tjera material, per ekzistimin e marreveshjes dhe per kerkesat e arritura te pa pembushura nga I padituri, sipas kesaj marreveshje.

Gjykata, te paditurive, me datë 14.10.2015, i ka dorezuar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padinë e paditëses, por te paditurit (si bashkndergjygjeses unik) brenda afatit të caktuar ligjor, me aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi, nuk kane ushtruar në ketë gjykatë përgjigjen e tyre nëse e kundërtshtojn apo jo kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa gjykata nga provat e cështjes ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësja, si dhe duke patur parasysh faktin se te paditurit kane pranuar me rregull padine me prova dhe aktvendimin per pergjigje ne padi (personalisht e paditura e dyte), gjykata bazuar ne nenin 150.6 te LPK-së ka vendosur që të marrë aktgjykim per shkak te pa degjueshmerise-mosbindjes, pa dëgjimin e palëve ndërgjygjëse.



Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 të LPK-së, që përjashton mundësin për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Gjykata lidhur me kamaten ka vendosur në bazë të nenit 277 të LMD-se, duke qenë se për paditësen lartësia e dëmit ka qenë e ditur në kohën e ngritjes së padisë, sipas vet marreveshjes që të padituri, si bashkehuamarres, kanë lidhur me paditësen.

Gjykata ka obliguar të paditurin për kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore në bazë të nenit 452.1 të LPK-se, ndërsa paditësen në bazë të UA nr.2008/2 të KGJK-se, për unifikimin e taksave gjyqesore.

### GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.192/15 date 03.11.2015

Gjyqtari,

Enes Mehmeti



**Keshilla juridike:** Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate. Afati fillon nga dita e neserme e pranimit te ketij aktgjykimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më 24 12 20 15  
Dana



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

VENDIMI ËSHTË I EKZEKUTUESHËM  
ODLUKA JE IZVRŠNA

Më dt. 21.01.2016 vit.  
Dana 21.01.2016 god.

Punëtori i autorizuar  
Ovlašćeni radnik

